



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.108/17

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Halide Reka, kryetare e kolegjit, Gëzim Llulluni dhe Nora Bllaca - Dula, anëtar, në çështjen juridike kontestimore të paditësit F.D. nga fshati ..., Komuna e Vushtrrisë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson J.I., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës sh.a në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Shukrije Tërrnava, për kompensim dëmi, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, e paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1556/09 i datës 22.02.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 19.02.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar ankesa e të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës në Prishtinë, **NDRYSHOHET** Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1556/09 i datës 22.02.2016 dhe gjykohet si në vijim: **DETYROHET** e paditura Korporata Energjetike e Kosovës në Prishtinë që paditësit F.D. nga fshati ..., Komuna e Vushtrrisë, në emër të dëmit jo material të cilin e ka pësuar për shkak të lëndimeve të lehta trupore të marra me datë 28.03.2006 gjatë kryerjes së detyrave të tij te punës, e nga baza e përgjegjësisë objektive, si shkaktare sekondare në shkallën e kontributit prej 30% në rastin e ndodhur, t'ia paguaj shumat :

- Për dhimbje fizike, shumën prej 500.00 Euro.

- Për frikën e përjetuar, shumën prej 450.00 Euro,

-të gjitha këto me kamatë vjetore të cilën e paguajnë bankat afariste në Kosovë për mjetet e deponuara në bankë mbi një vit pa destinim të caktuar, e cila do të llogaritet nga data e marrjes së aktgjykimit në gjykatën e shkallës së parë, respektivisht nga data 22.02.2016, e deri në pagesën definitive.

Pjesa tjetër e kërkesëpadisë për këto kategori të dëmit përtej shumave të gjykuara *refuzohet si e pabazuar*.

II. DETYROHET e paditura që paditësit F.D. t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës në lartësi prej 239.00 Euro, ndërsa pjesa tjetër e kërkesës për shpenzime të procedurës mbi shumën e gjykuar refuzohet si e pa bazuar.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.1556/09 i datës 22.02.2016, në pikën I (një) të dispozitivit e ka miratuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit F.D. nga fshati ..., Komuna e Vushtrrisë dhe e ka detyruar të paditurën KEK sh.a Prishtinë që paditësit në emër të kompensimit të dëmit jo material për lëndimin e pësuar në vendin e punës më datë 28.03.2006, t'ia paguaj shumat e specifikuara si më poshtë:

Në emër të dëmit jo material:

- për dhimbje fizike shumë e parave 1000 Euro,
- për frikë shumë 1000 Euro –të gjitha këto me kamatë ligjore e cila llogaritet nga data e marrjes së aktgjykimit e deri në pagesën definitive.

Në pikën II (dy) të dispozitivit (*të cilën gjykata e shkallës së parë e ka shënuar gabimisht si pika III*), e ka detyruar të paditurën që në afatin kohor prej 15 dite nga pranimi i aktgjykimit, paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës në shumë e parave prej 799 Euro.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur e paditura, duke e atakuar të njëjtin për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të LPK-së, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim bërë Gjykatës së Apelit që të aprovohet ankesa e të paditurës si e bazuar dhe aktgjykimi i atakuar të ndryshohet me refuzimin e kërkesëpadiës si të pabazuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pjesërisht e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurës, kërkesën e së cilës e ka precizuar me parashtresën e dt. 14.10.2015, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit në emër të kompensimit të dëmit jo material i cili i është shkaktuar në aksidentin e ndodhur në vendin e tij të punës me datë 28.03.2006, t'ia kompensoj shumë e tërësishme prej 3,500.00 Euro, me kamatë ligjore si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padiës së paditësit pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse si dhe shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.1556/09 i datës 22.02.2016, me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitivin e të njëjtit.

Lidhur me bazën e kërkesëpadiës së paditësit gjykata e shkallës së parë vendimin e saj e ka mbështetur në dispozitat ligjore të nenit 173, 174 dhe 192 të LMD-së, duke arsyetuar se me provat shkresore të administruara gjatë shqyrtimit kryesor, e veçmas mendimi me shkrim i datës 13.05.2015 i dhënë nga eksperti i mbrojtjes në punë A.K., të cilës gjykata në tërësi ja ka falur besimin, fletëparaqitja e fatkeqësisë në punë nr. 46 e datës 31.03.2006, të cilave prova po ashtu gjykata ju ka fal besimin e plotë, për gjykatën u bë jokontestues fakti se me datë 28.03.2006, në lokacionin punues të të paditurës, paditësi posa përfundon punën në pozicionin 126 duke ecur shkallëve në pozicionin 122 (në podrum) rrëshqet dhe rrëzohet, ku e lëndon këmbën e majtë.

Më tej gjykata ka arsyetuar se përgjegjësi primare për rastin e ndodhur sipas gjetjeve dhe konstatimeve të bëra në mendimin e tij profesional të dhënë nga eksperti i mbrojtjes në punë, mban paditësi për shkak të moskujdesit të duhur të tij me rastin e lëvizjes nëpër shkallë, mungesës së vigjilencës për të vërejtur defektet në ambientin e punës dhe mos paraqitjen e tyre te personi përgjegjës i mirëmbajtjes. Përgjegjësia sekondare i takon punëdhënësit dhe bazohet në mos trajnimin e punëtorit nga fusha e sigurisë dhe mbrojtjes në punë, konform obligimit ligjor sipas Ligjit nr.20003/19 neni 2.8, mos identifikimin dhe mos eliminimin e defektit në hapësirën punuese respektivisht në pllakën para shkallëve nga personeli i mirëmbajtjes së njësisë punuese.

Sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë së paditësit, gjykata e shkallës së parë vendimin e saj e ka bazuar në dispozitën ligjore të nenit 200 dhe 192 të LMD-së, e duke marrë për bazë mendimin profesional të dhënë në ekspertizën e datës 06.10.2015, nga ekspertët mjekësor Dr. F.M.-Ortoped, Traumatolog, dhe Dr. N.M.-Psikiatër, të cilët kanë konstatuar se paditësi si pasojë e aksidentit të ndodhur në vendin e tij të punës me datë 28.03.2006, si shkak i rrëzimit të tij në shkallë ka pësuar këto lëndime trupore: Distorzion i nyjës talokrurale dhe ky lëndim klasifikohet si lëndim i lehtë trupor .

Paditësi si pasojë e lëndimeve të marra ka përjetuar dhimbje fizike të intensitetit të rëndë në kohëzgjatje prej 24 orë herë pas here deri në veprimin e terapisë adekuate, dhimbje të intensitetit të mesëm për 14 ditë, dhimbje të kohëpaskohshme deri në aplikimin e terapisë adekuate të ndërlydhura me aktivitetin fizik gjatë lëvizjeve dhe vertikalizimin e paditësit për kryerjen e nevojave të tij personale dhe dhimbje të intensitetit të ulët në kohëzgjatje prej 14 ditë. Ka përjetuar frikë primare e cila ka zgjatur disa sekonda, frikë sekondare të intensitetit të lartë e cila ka zgjatur 24 orë dhe frikë sekondare të intensitetit të ulët që ka zgjatur 3 muaj.

Mendimit profesional të dhënë nga ekspertët e mjekësisë Dr. F.M. - ortoped, Traumatolog dhe Dr. N.M.-Psikiatër, gjykata e shkallës së parë del tu ketë falur besimin e plotë, duke vlerësuar se përmbajnë elementet e nevojshme dhe të dhënat mbi bazën e njohurive profesionale, duke përfshirë edhe arsye të mjaftueshme për vërtetimin e fakteve vendimtare sipas çështjes kontestimore në fjalë.

Vendimin për kamatën gjykata e shkallës së parë e ka marrë duke u bazuar në nenin 277 të LMD-së ndërsa për shpenzimet e procedurës ka vendosur konform nenit 449 dhe 452 par.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, por e drejta materiale është aplikuar gabimisht në pjesën që aktgjykimi është ndryshuar.

Pretendimi ankimor i të paditurës se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë më shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit është pretendim tërësisht i paqëndrueshëm, për faktin se kjo gjykatë konstaton se dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë dhe i përshtatshëm për përmbarrim, e në përputhje të plotë edhe me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë dhe lartësinë e saj, ku në lidhshmëri me këtë edhe ka arsyetuar qartë mënyrën se si janë vërtetuar faktet dhe

mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar, të cilat janë të pranueshme edhe për këtë gjykatë.

Të pathemelta qëndrojnë pretendimet e të paditurës edhe për gjendjen faktike, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes lidhur me çështjen kontestuese në fjalë nga gjykata e shkallës së parë janë provuar me prova përkatëse të cilat janë administruar në procedurën kontestimore të udhëhequr tek ajo gjykatë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, gjykata e shkallës së parë duke vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejtë ka zbatuar të drejtën materiale sa i përket bazës së kërkesëpadisë së paditësit kur e njëjta ka ardhur në përfundimin se ekziston detyrimi ligjor i të paditurës që nga baza e përgjegjësisë objektive, e në shkallën e përgjegjësisë së saj si shkaktare sekondare në rastin e ndodhur, përgjegjësi kjo që kap shkallën prej 30% për të paditurën dhe 70% për vet paditësin si shkaktar primar, ta kompensoj paditësin në shkallën e përgjegjësisë së saj objektive për dëmin i cili i është shkaktuar me rastin e lëndimit të tij në punë, pasi që me provat të cilat i ka administruar gjykata e shkallës së parë pa dyshim është vërtetuar fakti se lëndimi i paditësit në vendin e tij të punës ka ardhur si shkak i moskujdesit dhe neglizhencës së tij por gjithashtu edhe i lëshimeve në zbatueshmërinë e masave mbrojtëse dhe sigurisë në vendin e punës, që pa asnjë dyshim ka qenë nën përgjegjësinë e të paditurës si punëdhënës.

Më tej gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se me provat e nxjerra po ashtu është vërtetuar fakti se shkallët në të cilat është rrëzuar paditësi janë të punuara konform standardit për këtë lloj të objektit, por shërbimi i mirëmbajtjes nuk i ka përmbushur obligimet e veta duke mos i evituar shkaputjet e llamarinës kurse paditësi meqë ka lëvizur shumë herë më parë në ato shkallë do të duhej ta vërente defektin dhe duhej ta kishte paraqitur te personat përgjegjës, ku nën rrethanat e tilla të konstatuara përgjegjësia primare për shkaktimin e aksidentit bie mbi paditësin, ndërsa përgjegjësi sekondare ka e paditura e cila me mos veprimet e saja të ndërmarra në lidhje me mirëmbajtjen e shkallëve ka kontribuar në dëmin e ndodhur dhe pasojat e shkaktuara.

Nga një gjendje e tillë e fakteve të cilat janë provuar nga gjykata e shkallës së parë, sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së dytë paditësi mban përgjegjësi primare në shkallën prej 70 % për dëmin e pësuar, pasi që i njëjti duke u treguar i pa kujdesshëm gjatë lëvizjes nëpër shkallë është rrëzuar e gjithashtu nuk i ka njoftuar personat përgjegjës që të bëjnë mirëmbajtjen e shkallëve, ndërsa përgjegjësi objektive sekondare në shkallën prej 30 % për dëmin e shkaktuar paditësit mban e paditura pasi që e njëjta si punëdhënës ka pasur për detyrim që gjatë gjithë kohës të bëjë mirëmbajtjen dhe kontrollimin e hapësirave punuese dhe trajnimin e punëtorëve nga fusha e sigurisë dhe mbrojtjes në punë, çka është obligim ligjor i të paditurës dhe të cilën nuk e kishte bërë.

Me dispozitën e nenit 174 të LMD-së, shprehimisht parashihet "*Për dëmin nga sendi i rrezikshëm përgjigjet zotëruesi i saj, kurse për sendin nga veprimtaria e rrezikshme përgjigjet personi që merret më të. Zotërues konsiderohet poseduesi i sendit si dhe personi shoqëror juridik që ka të drejtë disponimi, respektivisht të drejtë shfrytëzimi të përkohshëm*". Me dispozitën ligjore të nenit 177 par. 3 të LMD-së shprehimisht parashihet "*Zotëruesi lirohet nga përgjegjësia pjesërisht në qoftë se dëmtuesi pjesërisht ka kontribuar në lindjen e dëmit*"

Sa i përket lartësisë së dëmit të gjykuar nga gjykata e shkallës së parë, Gjykata e Apelit duke marrë për bazë pjesërisht si të bazuar ankesën e palës së paditur, ka vendosur që aktgjykimin e ankimuar ta ndryshojë duke vendosur si në pikën I (një) të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi

që ka vlerësuar se shumata e gjykuara paditësit për këto forma të dëmit sipas aktgjykimit të ankimuar nuk janë në proporcion me kontributin e këtu palëve ndërgjyqëse në shkaktimin e lëndimit e po ashtu nuk janë në harmoni me rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimin për të cilin shërben kompensimi, pasi që sipas mendimit të kësaj gjykate, çdoherë është obligim ligjor i gjykatës që me rastin e vendosjes për këto kategori të dëmit jo material po edhe formave tjera të dëmit jo material, të kujdeset që shpërblimi i gjykuar të jetë satisfakcion për palët e dëmtuara, duke shmangur qëllimet tjera lukrative (materiale) të cilat do të humbnin qëllimin e shpërblimit dhe që shpërblimi i gjykuar të jetë në përputhje edhe me praktikën e mirë gjyqësore.

Sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së dytë shpërblimi në të holla i kësaj kategorie të dëmit jo material nuk është qëllim, por mjet me të cilin të dëmtuarit deri diku ja zbut pasojat e pakëndshme të cilat i ka pësuar paditësi me rastin e lëndimit të tij në punë, të cilat sigurisht që përbëjnë një përjetim të pakëndshëm, me çka shpërblimi në të holla i gjykuar paditësit nga Gjykata e Apelit për këto dy kategori të dëmit jo material në shumën e përgjithshme prej 950.00 Euro, paditësit do ti shërben si satisfaksion moral dhe si një përjetim i këndshëm, për zbutjen e pasojave duke i kënaqur disa nevoja të caktuara jetësore, duke ja bërë deri diku më të lehtë jetën e tij dhe harruar përjetimin e pakëndshëm të cilin e ka pësuar si pasojë e lëndimeve të marra nga aksidenti në punë.

Lidhur më lartësinë e kompensimit për këtë lloji dëmi jo material kjo gjykatë mori parasysh posaçërisht natyrën e lëndimeve trupore, intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve fizike, intensitetin, kohëzgjatjen dhe mënyrën e manifestimit të frikës, të cilat i ka pësuar paditësi në aksidentin e ndodhur, sipas gjetjeve dhe mendimit profesional të dhënë nga ekspertët mjekësor, e duke marrë për bazë shkallën e përgjegjësisë së të paditurës dhe vet paditësit në rastin e ndodhur, por edhe praktikën e deritanishme gjyqësore, duke u siguruar që kompensimi i gjykuar të jetë satisfakcion për paditësin dhe shmangur qëllimet tjera materiale (lukrative) që mund të bien ndesh më qëllimin e satisfakcionit në raste të tilla.

Gjykata e Apelit e Kosovës sipas pretendimit ankimor të t' paditurës ka vendosur si në pikën II (dy) dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e ndryshuar aktgjykimin e atakuar edhe sa i përket shpenzimeve të procedurës dhe duke i gjykuar shumën prej 239 Euro, bazuar në dispozitën e nenit 452.2 të LPK-së, ngase shumata e gjykuara nga gjykata e shkallës së parë, nuk ishin në përputhje me këtë dispozitë ligjore e duke pasur parasysh suksesin e palëve në kontest dhe në kontributin e vet paditësit në shkaktimin e aksidentit.

Gjykata e Apelit, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale, vlerëson se kamata është gjykuar në pajtim me dispozitën e nenit 277 të LMD-së.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (e) e lidhur 201 paragrafi 1 pika (d) të LPK-së, u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.108/17, me datë 19.02.2021

Kryetarja e kolegjit

Halide Reka, d.v

